

	DALESH - DLAQNA - GLOZON PERLAKA EXCELSIOR, PERLAKA LTD., REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA DEDJAN, DEDJANE AND DEDJAN MUNICIPALITY
Name & Surname Address City, zip No. pages	<u>7: Prokopenici</u> <u>40679</u> <u>02</u> <u>29.11.2019</u> <u>KC</u>

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

“GOP”Sh.p.k. – Deçan, (ne vazhdim “Furnizuesi”), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizim me:

Titulli I kontratës: Furnizim me material për mirëmbajtjen e shkollave dhe OKMF,dhe institucione tjera

me numr identifikues: 631-19-8548-1-2-1 me nr. Të brendshëm 631 19 058 121

Nenj 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim: Furnizim me material për mirëmbajtjen e shkollave dhe QKMF, dhe institucionet tjera sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit dhe ofertën financiare.

[Përdorimi i kësaj Kontrate Publike Kornizë është obliguese për të gjitha Autoritetet Kontraktuese të specifikuara në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indicative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëra; të përmendura në 1.1.

1.5 Kontrata hynë në fuqi me 29.11.2019 dhe përfundon në datën 29.11.2021.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 5 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë në shkolla, QKMF, Administratën Komunal

[Vendi i dërgimin të furnizimeve do të jetë në adresën e treguar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.]

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të originës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi Vlera totale indikative e kontratës është **47.905,50 Euro**. Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative është [+ - 30%].

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve); 19.11.2019
- (f) Urdhër blerja;

¹⁷ DDP – Dergesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetër; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvèç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet [Shqipe] in në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Xhevdet Ramosaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	29.11.2019
Vula:	

Për Furnizuesin

Emri:	Armend Qorraj
Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:	
Data:	29.11.2019
Vula:	



angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përvèç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhreve të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 29

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 30

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

30.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- ose vendim nga gjyqi; ose
- kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

30.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES: **kushtet e veçanta**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	

Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha shqipe .
Siguria ekzekutimit	e 8.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në afat prej 25 muaj .
Sigurimi	9.1	[Specifikonit kërkesat specifike të sigurimit]
Cilësia furnizimeve	e 16.2	<i>Pas pranimit të mallit dhe nënshkrimit të fletpranimit nga personi i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.</i>
Inspektimi testimi	dhe 17.2	<i>Inspektimi dhe testimi do të bëhet me rastin e dorzimit dhe në harmoni m,e nenin 17 të kushteve të përgjithshme të kontratës.</i>
Dorëzimi	19.3	<i>Furnizuesi do të bartë të gjitha rreziqet qe kan te bëjnë me mallrat deri në pranim në desntinacion .Furnizimet duhen të paketohen në mënyrë që të parandalohet demtimi i tyre deri në destinacionin e tyre.</i> <i>Dergesa do të bëhet më së largu mbranda 5 dite pas marrjes së urdhër blerjes nga ana e furnizuesit.</i> Pagesat do të bëhen nga Autoriteti Kontraktues pas lshimt të urdhër blerjes ,furnizuesi duhet të dorzoi faturën originale .
Obligimet garacionit	e 22.1	<i>Furnizuesi do të garantojë që furnizimet jan të reja ,të pa përdorura ,të modeleve të fundit .Furnizuesi do të garantoj që asnji nga furnizimet mos të ken defekt që shkaktohet nga dizajni,materjalet apo mjeshtria.Kjo garanci do të mbetët e vlefshme për 12 muaj pas pranimit të përkohshëm,garacioni për një periudhë minimale prej 12 muaj/ defektet e fshehura (defektet e fshehura jan defektet që nuk jan të dukshme per blersin në vëzhgim normal.</i>
	22.5	[Specifikonit ndonjë obligim shtesë sipas garancisë]
Shërbimet pas shitjes	pas 23.1	N/A

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Nese vije deri te kontestinë mes te palëve kontraktuese atëherë ato do te mundohen ti zgjtdhin me marveshje reciproke përmes bisedimeve.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në <i>Gjykatën Ekonomike në Prishtinë</i>. në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligiin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</p>